



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 193

Tiranë – E premte, 29 dhjetor 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 98/2023, datë 14.12.2023	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit “Qëndrueshmëria ndaj klimës dhe zhvillimit të bujqësisë”..... 23765
Dekret i Presidentit nr. 393, datë 27.12.2023	Për shpallje ligji..... 23772
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 755, datë 20.12.2023	Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për disa institucione të pavarura të krijuara me ligj 23772
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 767, datë 20.12.2023	Për një shtesë në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar..... 23773
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 787, datë 28.12.2023	Për rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të nevojës, hartimit, bashkëpunimit, miratimit dhe funksionimit të metodave apo të seksioneve të reja të platformës “Me ty për Shqipërinë që duam”..... 23774
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 793, datë 28.12.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar..... 23776

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 794, datë 28.12.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës”, të ndryshuar	23778
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 796, datë 28.12.2023	Për një ndryshim në vendimin nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”	23781
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 799, datë 28.12.2023	Për disa ndryshime në vendimin nr. 465, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Task-Forcës për përmirësimin e nivelit të kontrollit të mjeteve motorike e rimorkiove të tyre”, të ndryshuar	23782
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 801, datë 28.12.2023	Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 571, datë 6.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të 35 njësive individuale të banimit në zonën e re për zhvillim, Njësia Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë, në kuadër të marrëveshjes së grantit të lidhur, ndërmjet Agjencisë së Zhvillimit Austriak (ADA) dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, për projektin ‘Përgjigje ndaj tërmeteve në Shqipëri’”	23782
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 803, datë 28.12.2023	Për miratimin e buxhetit për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për vitin 2024.....	23783
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 804, datë 28.12.2023	Për një ndryshim në vendimin nr. 750, datë 1.12.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e buxhetit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2023”	23784
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 805, datë 28.12.2023	Për përcaktimin e statusit, mënyrave të pjesëmarrjes dhe masës së dietës ditore për vështirësi shërbimi të personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin e Kombeve të Bashkuara në <i>Abeyi</i> (UNISFA).....	23785
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 808, datë 28.12.2023	Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Gardës së Republikës.....	23785
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 809, datë 28.12.2023	Për disa shtesa në vendimin nr. 597, datë 13.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e personaliteteve dhe objekteve të tjera që ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.....	23786
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 810, datë 28.12.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 478, datë 10.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurën e sigurisë së gjyqtarëve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit”	23786

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 813, datë 28.12.2023	Për disa ndryshime në vendimin nr. 531, datë 7.9.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i blerjeve të përqendruara” sh.a., për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrave dhe institucioneve të varësisë”.....	23787
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 815, datë 28.12.2023	Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar.....	23788
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 819, datë 28.12.2023	Për shpërblimin e kategorisë së personave që përfitojnë pension invaliditeti dhe pension familjar, për vitin 2023.....	23791
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 28.12.2023	Për financimin e Federatës Shqiptare të Futbollit, për mbështetjen e Ekipit Kombëtar të Futbollit.....	23791
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 28.12.2023	Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 288, datë 10.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës dhe të procedurës së dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura dhe mënyrën e bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve të shërbimit spitalor dhe atyre të gjendjes civile”.....	23792
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 832, datë 28.12.2023	Për disa ndryshime në vendimin nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, të ndryshuar”.....	23793
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 834, datë 28.12.2023	Për një ndryshim në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar, dhe për shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023, miratuar për disa institucione	23794
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 836, datë 28.12.2023	Për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të znj. Briseida Jahollari.....	23796
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 837, datë 28.12.2023	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Bujar Bukoshi.....	23796
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 838, datë 28.12.2023	Për një shtesë në vendimin nr. 125, datë 1.3.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2023”.....	23796

**LIGJ**
Nr. 98/2023**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM PËR FINANCIMIN E
PROJEKTIT “QËNDRUESHMËRIA
NDAJ KLIMËS DHE ZHVILLIMIT
TË BUJQËSISË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:****Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit “Qëndrueshmëria ndaj klimës dhe zhvillimit të bujqësisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.12.2023.

Shpallur me dekretin nr. 393, datë 27.12.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

NUMRI I HUAS 94890-AL**MARRËVESHJA E HUAS**
(PROJEKTI “QËNDRUESHMËRIA NDAJ
KLIMËS DHE ZHVILLIMIT TË
BUJQËSISË”) NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM**MARRËVESHJE HUAJE**

Marrëveshje e datës së nënshkrimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Huamarrësi”) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”). Huamarrësi dhe Banka me anë të kësaj bien dakord si më poshtë:

Neni I**Kushtet e Përgjithshme; Përkufizimet**

1.01. Kushtet e Përgjithshme (siç përcaktohen në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) zbatohen dhe janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

1.02. Përveç rasteve kur konteksti kërkon ndryshe, termat me shkronjë të madhe të përdorur në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u jepen atyre në Kushtet e Përgjithshme ose në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni II**Huaja**

2.01. Banka pranon t’i japë Huamarrësit shumën prej gjashtëdhjetë e katër milionë e gjashtëqind mijë (64,600,000 euro), siç kjo shumë mund të konvertohet herë pas here nëpërmjet një konvertimi valutor (“Huaja”), për të ndihmuar në financimin e projektit të përshkruar në skedulin 1 të kësaj Marrëveshjeje (“Projekti”).

2.02. Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e Huas, në përputhje me seksionin III të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.03. Tarifa paraprake është një e katërta e një për qind (0.25%) të shumës së huas.

2.04. Tarifa e zotimit është një e katërta e një për qind (0.25%) në vit mbi tepricën e huas së patërhequr.

2.05. Norma e interesit është norma e referencës plus përhapja e ndryshueshme ose



norma e tillë që mund të zbatohet pas një konvertimi; në bazë të seksionit 3.02(e) të Kushteve të Përgjithshme.

2.06. Datat e pagesës janë 1 maji dhe 1 nëntori i çdo viti.

2.07. Shuma e principalit të huas do të paguhet në përputhje me skedulin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni III

Projekti

3.01. Huamarrësi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të Projektit. Për këtë qëllim, Huamarrësi do të kryejë projektin, nëpërmjet MBZHR-së, në përputhje me dispozitat e nenit V të Kushteve të Përgjithshme dhe skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni IV

Hyrja në fuqi; Përfundimi

4.01. Kushtet shtesë të hyrjes në fuqi përbëhen nga sa vijon:

a) Huamarrësi, nëpërmjet MBZHR-së, ka përgatitur dhe miratuar një Manual Operacional të Projektit në një mënyrë të pranueshme për Bankën.

b) Huamarrësi, nëpërmjet MBZHR-së, ka krijuar EMP-në me staf, terma ose referenca dhe kompetenca të pranueshme për Bankën.

4.02. Afati i hyrjes në fuqi është data 120 (njëqind e njëzet) ditë pas datës së nënshkrimit.

Neni V

Përfaqësuesi; Adresat

5.01. Përfaqësuesi i Huamarrësit është Ministri i tij i Financave dhe Ekonomisë.

5.02. Për qëllime të seksionit 10.01 të Kushteve të Përgjithshme:

a) adresa e Huamarrësit është:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3
Tiranë, Shqipëri; dhe

b) Adresa elektronike e Huamarrësit është:
E-mail: sekretariamin@financa.gov.al

5.03. Për qëllime të seksionit 10.01 të Kushteve të Përgjithshme:

a) adresa e Bankës është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

Faqe | 23766

1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433

United States of America (Shtetet e Bashkuara të Amerikës); dhe

b) Adresa elektronike e Bankës është:

Teleks: Faksimile:

248423 (MCI) ose 1-202-477-6391

64145 (MCI)

Miratuar që nga data e nënshkrimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri: DELINA IBRAHIMAJ

Titulli: MINISTRE E FINANCEVE DHE EKONOMISË

Data: 4.8.2023

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri: EMANUEL SALINAS

Titulli: MENAXHER LOKAL

Data: 4.8.2023

SKEDULI 1

PËRSHKRIMI I PROJEKTTIT

Objekti i projektit është të rrisë konkurrencën dhe qëndrueshmërinë klimatike të zinxhirëve prioritarë të vlerës agroushqimore.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1. Promovimi i bujqësisë inteligjente klimatike dhe aksesit në tregje

1.1 Promovimi i Zinxhirëve të Vlerave inteligjente dhe elastike të Klimës

Mbështetja e sistemit elastik të shpërndarjes së ushqimit dhe promovimi i shtimit të vlerës së prodhimit bujqësor përmes:

i. Zhvillimit të zinxhirëve të shkurtër të vlerës

Ofrimi i mbështetjes për zhvillimin e Qendrave Mikroushqimore (“QMU”) në zonat periferike të



qyteteve kryesore në Rajonet e Përzgjedhura për të ofruar akses më të mirë në treg për prodhuesit vendës, duke mbështetur zinxhirët e shkurtër të furnizimit dhe elasticitetin në furnizimin e zonave urbane me ushqim përmes:

a) përgatitjes së studimeve të fizibilitetit, planeve të biznesit, kërkesave mjedisore dhe sociale dhe projekteve të detajuara dhe planeve të mbikëqyrjes së ndërtimit për të gjitha objektet;

b) ndërtimit të objekteve dhe të pajisjeve përkatëse; dhe

c) udhëzimit operacional për fillimin e aktiviteteve.

ii. Promovimit të produkteve tipike dhe shtimit të vlerës

Ofrimi i mbështetjes për zhvillimin e grupeve tipike të produkteve ushqimore në Rajonet e Përzgjedhura, përmes:

a) asistencës teknike për ndërtimin e konsorciumit të prodhuesve, zhvillimin e kapaciteteve të tyre teknike dhe të marketingut dhe promovimin e cilësisë, markës dhe komercializimit; dhe

b) ndërtimit të njësive të përpunimit për të rritur vlerën e shtuar të produkteve vendëse.

iii. Zhvillimit të një Platforme TI për Bujqësi Inteligjente Klimatike ("CSA").

Ofrimi i mbështetjes, për:

a) zhvillimin e softuerit të platformës CSA, përfshirë zbatimin e sistemit në një zonë pilot dhe Trajnim për përfutuesit; dhe

b) blerjen e harduerit të nevojshëm dhe të sensorëve që do të instalohen në zonën pilot sipas pjesës 1.1 (iii) (a) të Projektit, duke përfshirë shërbimet e mirëmbajtjes.

1.2 Modernizimit të Skemave të Përzgjedhura të Ujitjes dhe Kullimit për Prodhim Bujqësor me Vlerë të Lartë

i. Modernizimi dhe presimi i Skemës së Ujitjes, Dënjakë

Ofrimi i mbështetjes për modernizimin e rrjeteve dytësore dhe tretësore, duke konvertuar sistemin e ujitjes të kanalit të hapur (ose pompimin nga kullimet dhe pusët) në një rrjet të ri të mbyllur dhe nën presion, nëpërmjet: a) përditësimit të projektimit dhe preventivëve; b) kryerjes së punimeve të ndërtimit për presionin e rrjeteve dytësore dhe tretësore; c) kryerjes së mbikëqyrjes së punëve të ndërtimit; dhe d) kryerjes së instalimit të paneleve diellore.

ii. Modernizimit dhe presimit të Skemës së Ujitjes, Mursi

Përmirësimi i Skemës së Ujitjes, Mursi, nga kanali i hapur në ujitje me presion përmes:

a) kryerjes së përditësimit të projektimit dhe preventivëve;

b) ndërtimit të një stacioni të ri pompimi dhe presioni të rrjeteve dytësore në fushat e Mursit, Vrinës dhe Xarrës ; dhe c) instalimit të paneleve diellore.

iii. Rivitalizimi i Skemës së Ujitjes së Lushnjës

Ofrimi i mbështetjes për zhvillimin e burimeve alternative të ujitjes për fermerët dhe rifillimi i shërbimeve të ujitjes për fermerët përfutues më herët nga dega e Lushnjës nëpërmjet:

a) kryerjes së një analize të mundësive alternative për furnizimin me ujë vaditës të zonës bujqësore të Lushnjës, përfshirë zhvillimin e studimit të fizibilitetit dhe projektimit për të gjithë sipërfaqen e punueshme; dhe

b) pilotimin e opsionit të identifikuar të ujitjes, përfshirë: a) përgatitjen e projektimit dhe të preventivëve; b) kryerjen e punimeve të ndërtimit; c) kryerjen e mbikëqyrjes së punëve të ndërtimit.

iv. Modernizimit të sistemeve të kullimit

Ofrimi i mbështetjes për të rritur eficiencën e energjisë, reduktuar kostot e operimit dhe mirëmbajtjes, rritur produktivitetin bujqësor dhe të ardhurat e fermës përmes sa vijon:

a) përmirësimit dhe modernizimit, duke përfshirë instalimin e pompave moderne më efikase dhe fleksibël, të dy stacioneve të pompimit të kullimit të përzgjedhur në Seman dhe Darzezë;

b) projektimit dhe instalimit të sistemit të mbikëqyrjes, kontrollit dhe grumbullimit të të dhënave ("SCADA") në stacionet e pompimit të kullimit, të modernizuar me opsione për t'u zgjeruar në të ardhmen në stacione të tjera, dhe instalimit të sensorëve monitorues në stacionet e mbetura të pompimit të kullimit; dhe

c) instalimit të SPV-ve në stacionet e pompimit të kullimit.

Pjesa 2. Rritja e Përputhshmërisë me Standardet e Sigurisë dhe Cilësisë së Ushqimit

i. Krijimi dhe përmirësimi i Vendeve të Inspektimit Kufitar ("PIK")

Rritja e kapacitetit institucional të Huamarrësit për të kryer kontrole zyrtare për kafshët e gjalla, produktet me origjinë shtazore dhe joshkazore, bimët dhe produktet bimore, si dhe inputet bujqësore nëpërmjet rehabilitimit dhe pajisjes së PIK-ve të përzgjedhura, duke përfshirë:



a) përgatitjen e projekteve të detajuara dhe mbikëqyrjen e ndërtimit për objektet, si dhe çdo instrument të nevojshëm mjedisor dhe social specifik për vendndodhjen;

b) ndërtimin e objekteve, duke përfshirë instalimin e paneleve diellore dhe ofrimin e pajisjeve përkatëse; dhe

c) trajnimin dhe/ose mbështetjen për përditësimin e procedurave të inspektimit në PIK.

ii. Përmirësimi i kapaciteteve inspektuese dhe i mbështetjes diagnostikuese në fushën e sigurisë ushqimore, analizave veterinarë dhe shëndetit të bimëve

Rritja e kapacitetit për të kryer kontrolle fizike, marrjen e mostrave dhe dërgimin e mostrave në laboratorë, si dhe kapacitetin laboratorik dhe testues të laboratorëve referues të sigurisë ushqimore, veterinarë dhe shëndetit të bimëve për t'i mundësuar të zbatojnë sistemet dhe metodologjitë e nevojshme të monitorimit për testim, sipas standardeve përkatëse në përputhje me kërkesat e paraanëtarësimit në BE, përmes:

a) përgatitjes së projekteve dhe mbikëqyrjes për rehabilitimin e laboratorëve sipas nevojës, si dhe çdo instrument të nevojshëm mjedisor dhe social të zonës specifike;

b) rehabilitimit të objekteve, duke përfshirë instalimin e paneleve diellore;

c) ofrimin të pajisjeve;

d) trajnimeve dhe/ose mbështetjes për kryerjen e akreditimit të laboratorëve/metodave të testimit; dhe

e) mbështetjes për të lehtësuar përputhshmërinë operacionale me rregulloret përkatëse të BE-së.

iii. Zhvillimi i kapacitetit të ruajtjes përmes:

a) ndërtimit të objekteve të magazinimit me efikasitet të lartë të energjisë, duke përfshirë përgatitjen e projekteve dhe mbikëqyrjen; dhe

b) blerjes së pajisjeve.

Pjesa 3. Forcimi i kapaciteteve analizuese të bazuara në dëshmi të MBZHR-së dhe Bashkive

i. Zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të mbledhjes së të dhënave dhe rritja e efektivitetit dhe kapacitetit të efikasitetit të politikave të MBZHR-së, përmes:

a) ngritjes së një sistemi të Inteligjencës së Biznesit (BI) nëpërmjet instalimit të softuerit dhe harduerit të nevojshëm; dhe

b) asistencës teknike dhe trajnimeve.

ii. Forcimi i monitorimit dhe i menaxhimit të performancës së ujitjes dhe të kullimit në nivel qendror dhe bashkiak nëpërmjet:

a) rritjes së përdorimit të Sistemit Informativ të Menaxhimit të Ujitjes dhe Kullimit (“IDMIS”);

b) zhvillimit të hartës së Sistemit Informativ Gjeografik (“GIS”); dhe

c) ofrimin të trajnimit të trajnerëve për të siguruar që sistemi të përdoret nga bashkitë shtesë.

iii. Menaxhimi i projektit

Kryerja e aktiviteteve të menaxhimit të projektit, duke përfshirë: a) kryerjen e menaxhimit financiar dhe kërkesat e prokurimit të Projektit; b) monitorimin dhe vlerësimin e Projektit, përfshirë raportet e zbatimit të sondazheve të përfituesve, komunikimin dhe aktivitetet e reagimit të përfituesve; c) nëse është e nevojshme, rekrutimin e stafit/konsulentëve shtesë përgjegjës për administrimin e përgjithshëm, prokurimin, menaxhimin financiar, monitorimin dhe vlerësimin; dhe d) realizimin e kërkesave mjedisore dhe sociale të Projektit, si dhe aktivitetet e komunikimit dhe komunikimit, duke përfshirë, ndër të tjera, angazhimin e palëve të interesuara/zyrtarët.

SKEDULI 2

EKZEKUTIMI I PROJEKTTIT

Seksioni I. Masat e zbatimit

A. Masat institucionale

1. Huamarrësi do të caktojë, gjatë gjithë periudhës gjatë zbatimit të projektit: i. MBZHR-në që të jetë përgjegjëse për koordinimin e përgjithshëm të projektit; dhe ii. Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (“NFA”), Institutin për Sigurinë Ushqimore dhe Veterinarinë (“ISUV”), Drejtoritë e Ujitjes dhe të Kullimit, Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (“AKSHI”) dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (“NAVPP”) dhe bashkitë përkatëse me projektin, për të ofruar mbështetje teknike për MBZHR-në dhe EMP-në për zbatimin e aktiviteteve të tyre përkatëse.

2. Huamarrësi, nëpërmjet MBZHR-së, do të:

i. krijojë dhe më pas do të mbajë gjatë gjithë zbatimit të projektit, një ekip menaxhues të projektit brenda MBZHR-së (“PMT”), me përbërje, burime, terma reference dhe funksione të pranueshme për Bankën që të jetë përgjegjëse, për:



i. koordinimin e përgjithshëm të të gjitha aktiviteteve zbatuese të projektit; ii. sigurimin që kërkesat, kriteret, politikat, procedurat dhe masat organizative të përcaktuara në Manualin Operativ të Projektit, të aplikohen në zbatimin e Projektit; iii. përgatitjen e të gjitha dokumenteve të zbatimit të projektit, duke përfshirë raportet e progresit të projektit; dhe iv. monitorimin dhe vlerësimin e projektit;

ii. jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas datës së hyrjes në fuqi, të punësojë dhe më pas të mbajë gjatë gjithë zbatimit të projektit, një specialist mjedisor me kohë të pjesshme dhe specialist social me kohë të pjesshme me terma reference dhe kualifikime të pranueshme për Bankën.

3. Pas përfundimit të ndërtimit të objekteve sipas pjesës 1.1(i) dhe (ii), Huamarrësi, nëpërmjet MBZHR-së, do të lidhë një memorandum të veçantë menaxhimi (“Memorandum Menaxhimi”) me një subjekt publik dhe/ose privat, sipas termave dhe kushteve të pranueshëm për Bankën dhe të përcaktuara në POM, për të garantuar funksionimin dhe mirëmbajtjen e çdo MFH-je dhe grupi, në përputhje me standardet dhe praktikën e duhura administrative, teknike, financiare, ekonomike, mjedisore dhe sociale të përshkruara në POM.

B. Manuali Operacional i Projektit

1. Huamarrësi, nëpërmjet MBZHR-së, do të kryejë projektin në përputhje me dispozitat e një manuali (“Manuali Operativ i Projektit”), në një mënyrë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën.

2. Me përjashtim të rasteve kur Banka mund të bjerë dakord ndryshe me shkrim, Huamarrësi, nëpërmjet MBZHR-së, nuk do të shfuqizojë, ndryshojë, pezullojë, heqë dorë ose ndryshe nuk do të zbatojë Manualin Operativ të Projektit ose ndonjë dispozitë të tij.

3. Në rast të ndonjë konflikti midis kushteve të Manualit Operativ të Projektit dhe atyre të kësaj Marrëveshjeje, kushtet e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi.

C. Standardet Mjedisore dhe Sociale

1. Huamarrësi, nëpërmjet MBZHR-së, do të sigurojë që projekti të kryhet në përputhje me Standardet Mjedisore dhe Sociale, në një mënyrë të pranueshme për Bankën.

2. Pa kufizim në paragrafin 1 më sipër, Huamarrësi, nëpërmjet MBZHR-së, do të sigurojë që projekti të zbatohet në përputhje me Planin e

Angazhimit Mjedisor dhe Social (“ESCP”), në një mënyrë të pranueshme për Bankën. Për këtë qëllim, Huamarrësi do të sigurojë që:

a) masat dhe veprimet e specifikuar në ESCP zbatohen me kujdesin dhe efikasitetin e duhur, siç parashikohet në ESCP;

b) janë në dispozicion fonde të mjaftueshme për të mbuluar kostot e zbatimit të ESCP-së;

c) politikat dhe procedurat mbahen dhe personeli i kualifikuar dhe me përvojë në numra të mjaftueshëm, ruhet për të zbatuar ESCP-në, siç parashikohet në ESCP; dhe

d) ESCP-ja ose ndonjë dispozitë e tij, nuk ndryshohet, shfuqizohet, pezullohet ose hiqet dorë, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe me shkrim, siç specifikohet në ESCP, dhe garanton që ESCP-ja e rishikuar të njoftohet menjëherë pas kësaj.

3. Në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet ESCP-së dhe dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi.

4. Huamarrësi, nëpërmjet MBZHR-së, do të sigurojë që:

a) janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbledhur, përpiluar dhe për të dhënë Bankës nëpërmjet raporteve të rregullta, me shpeshtësinë e specifikuar në ESCP, dhe menjëherë në një raport ose raporte të veçanta, nëse kërkohet nga Banka, informacion mbi statusin e pajtueshmërisë me ESCP-në dhe instrumentet mjedisore dhe sociale të përmendura në të, të gjitha raportet e tilla në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, duke përcaktuar, ndër të tjera: i. statusin e zbatimit të ESCP-së; ii. kushtet, nëse ka, të cilat ndërhyjnë ose rrezikojnë të ndërhyjnë në zbatimin e ESCP-së; dhe iii. masat korrigjuese dhe parandaluese të marra ose që kërkohen të merren për të trajtuar këto kushte; dhe

b) Banka njoftohet menjëherë për çdo incident ose aksident që lidhet ose ka ndikim në projekt, i cili ka ose mund të ketë një efekt negativ të konsiderueshëm në mjedis, komunitetet e prekura, publikun ose punëtorët, në përputhje me ESCP-në, instrumentet mjedisore dhe sociale të referuara aty dhe Standardet Mjedisore dhe Sociale.

5. Huamarrësi, nëpërmjet MBZHR-së, do të krijojë, publikojë, mbajë dhe operojë një mekanizëm të aksesueshëm ankesash, për të marrë dhe për të lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe të ankesave të personave të prekur nga Projekti dhe



do të marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të duhura për të zgjidhur ose lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të tilla, në një mënyrë të pranueshme për Bankën.

6. Huamarrësi, nëpërmjet MBZHR-së, do të sigurojë që të gjitha dokumentet e tenderit dhe kontratat për punët civile, sipas Projektit përfshijnë detyrimin e kontraktorëve, nënkontraktorëve dhe subjekteve mbikëqyrëse që: a) të jenë në përputhje me aspektet përkatëse të ESCP-së dhe instrumentet mjedisore dhe sociale të referuara aty; dhe b) miratojnë dhe zbatojnë kode sjelljeje që duhet t'u sigurohen dhe të nënshkruhen nga të gjithë punëtorët, duke detajuar masat për të trajtuar rreziqet mjedisore, sociale, shëndetësore dhe të sigurisë, si dhe rreziqet e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual, ngacmimit seksual dhe dhunës ndaj fëmijëve, të gjitha sipas zbatimit të këtyre punimeve civile të porositura ose të kryera në përputhje me kontratat në fjalë.

Seksioni II. Raportimi dhe Vlerësimi i Monitorimit të Projektit

Huamarrësi, nëpërmjet MBZHR-së, do t'i dorëzojë Bankës çdo Raport Projekti jo më vonë se një muaj pas përfundimit të çdo semestri kalendarik, duke mbuluar semestrin kalendarik.

Seksioni III. Tërheqja e të ardhurave nga huaja

A. Të përgjithshme

Pa kufizim në dispozitat e nenit II të Kushteve të Përgjithshme dhe në përputhje me Letrën e Disbursimit dhe Informacionit Financiar, Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e Huas, për: a) financimin e Shpenzimeve të Pranueshme; dhe b) të paguajë: i. Tarifën Paraprake; dhe ii. çdo prim të nivelit të normës së interesit ose primit të opsionit të normës së interesit; në shumën e alokuar dhe, nëse është e zbatueshme, deri në përqindjen e përcaktuar për secilën kategori të tabelës së mëposhtme:

Kategoria	Shuma e huas Alokuar (shprehur në euro)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë taksat)
1. Mallra, punë dhe shërbime jokonsulente për Projektin	56,838,500	100%
2. Shërbimet e konsulencës, Trajnimi dhe Kostot Operative për Projektin	7,600,000	100%
3. Tarifa paraprake	161.500	Shuma e pagueshme në përputhje me seksionin 2.03 të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me seksionin 2.07(b) të Kushteve të Përgjithshme
4. Niveli i Normës së Interesit ose Primi i Opsionit të Normës së Interesit	0	Shuma e detyrimit në përputhje me Seksionin 4.05(c) të Kushteve të Përgjithshme
SHUMA TOTALE	64,600,000	

B. Kushtet e Tërheqjes; Periudha e Tërheqjes

1. Pavarësisht nga dispozitat e pjesës A më sipër, nuk do të kryhet asnjë tërheqje për pagesat përpara datës së nënshkrimit.

2. Data e mbylljes është 30 shtator 2028.

SKEDULI 3

SKEDULI I SHLYERJES SË AMORTIZIMIT TË LIDHUR ME ANGAZHIMIN

Tabela e mëposhtme përcakton datat e pagesës së principalit të huas dhe përqindjen e shumës totale të principalit të huas, që paguhet në secilën datë të pagesës së principalit ("Aksioni me këste").

Niveli i shlyerjeve të principalit

Data e pagesës së principalit	Aksioni me këste
Në çdo datë 1 maj dhe 1 nëntor Duke filluar nga data 1 maj 2030 deri më 1 maj 2044	3.33%
Më 1 nëntor 2044	3.34%



SHTOJCË

Përkufizimet

1. “Udhëzues Antikorrupsion” nënkupton, për qëllime të paragrafit 6 të Shtojcës së Kushteve të Përgjithshme, “Udhëzimet për parandalimin dhe luftimin e mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga huat e BERZH-it dhe kreditë dhe grantet e IDA-së”, datë 15 tetor 2006, dhe të rishikuar në janar 2011 dhe më 1 korrik 2016.

2. “Kategori” nënkupton një kategori të përcaktuar në tabelën në seksionin III.A të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

3. “Plani i Angazhimit Mjedisor dhe Social” ose “PSM” nënkupton planin e angazhimit mjedisor dhe social për projektin, datë 15 shkurt 2023, siç mund të ndryshohet herë pas here në përputhje me dispozitat e tij, ku parashtrohen masat dhe veprimet materiale që Huamarrësi do të kryejë ose do të marrë masa që të kryhen për të trajtuar rreziqet dhe ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale të Projektit, duke përfshirë afatet kohore të veprimeve dhe masave, masat institucionale, të personelit, trajnimit, monitorimit dhe raportimit, dhe çdo instrument mjedisor dhe social që do të përgatitet në bazë të tij.

4. “Standardet Mjedisore dhe Sociale” ose “ESS” nënkupton, bashkërisht: i. “Standardin Mjedisor dhe Social 1: Vlerësimi dhe Menaxhimi i Rreziqeve dhe Ndikimeve Mjedisore dhe Sociale”; ii. “Standardin Mjedisor dhe Social 2: Puna dhe Kushtet e Punës”; iii. “Standardin Mjedisor dhe Social 3: Efikasiteti i Burimeve dhe Parandalimi dhe Menaxhimi i Ndotjes”; iv. “Standardin Mjedisor dhe Social 4: Shëndeti dhe Siguria e Komunitetit”; v. “Standardin Mjedisor dhe Social 5: Blerja e tokës, kufizimet në përdorimin e tokës dhe zhvendosja e pavullnetshme”; vi. “Standardin Mjedisor dhe Social 6: Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore të Gjalla”; vii. “Standardin Mjedisor dhe Social 7: Popujt Indigjenë/Komunitetet Lokale Tradicionale Historikisht të Pashërbyera Afrikane Sub-Sahariane”; viii. “Standardin Mjedisor dhe Social 8: Trashëgimia Kulturore”; ix. “Standardi Mjedisor dhe Social 9: Ndërmjetësuesit Financiarë”; x. “Standardin Mjedisor dhe Social 10: Angazhimi i palëve të interesuara dhe zbulimi i informacionit”; në fuqi më 1 tetor 2018, siç është publikuar nga Banka.

5. “Kushte të Përgjithshme” nënkupton “Kushtet e Përgjithshme të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e IBRD-së, Financimin e Projekteve të Investimeve”, datë 14 dhjetor 2018 (rishikuar më 1 gusht 2020, 21 dhjetor 2020, 1 prill 2021 dhe 1 janar 2022).

6. “MBRZH” nënkupton Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Huamarrësit, ose çdo pasues të saj.

7. “Memorandum Menaxhimi” nënkupton marrëveshjen e përmendur në Seksionin I.A.4 të Skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

8. “Micro Food Hub” (“Qendra Mikroushqimore”) ose “MFH” nënkupton një biznes ose organizatë që menaxhon grumbullimin, shpërndarjen dhe tregtimin e produkteve ushqimore të identifikuara nga burimi kryesisht nga prodhuesit lokalë dhe rajonalë për të forcuar aftësinë e tyre për të përmbushur kërkesën me shumicë, pakicë dhe institucionale.

9. “Kosto operative” nënkupton shpenzimet e arsyeshme në rritje që rrjedhin nga Projekti dhe që përbëhen nga pagat e EMP-së (duke përjashtuar pagat e nëpunësve civilë të Huamarrësit) dhe shpenzimet e lidhura me zbatimin e aktiviteteve të projektit, kostot për mirëmbajtjen e zyrës, dietat për stafin, orendi zyre, materiale dhe furnizime, kosto komunikimi, reklama dhe kosto karburanti dhe transporti për vizitat në terren.

10. “Manual operativ i projektit” ose “POM” nënkupton manualin e përgatitur nga PMT-ja dhe të miratuar nga MBZHR-ja, në përputhje me seksionin 4.02(a) të kësaj Marrëveshjeje dhe referuar në seksionin I.B. në skedulën 2 të kësaj Marrëveshjeje, duke përcaktuar rregullat, metodat, udhëzimet dhe procedurat për realizimin e projektit, duke përfshirë, *ndër të tjera*: a) përshkrimin e detajuar të projektit dhe masat institucionale për zbatimin e tij, përfshirë përgjegjësitë dhe përgjegjshmëritë e secilës palë të interesuar, në kuadër të Projektit, në lidhje me zbatimin e aktivitetit dhe rezultatet përkatëse; b) procedurat e monitorimit, vlerësimit, raportimit dhe qeverisjes për Projektin; c) disbursimin, menaxhimin financiar, auditimin, duke përfshirë modelet për pasqyrat financiare, planin e llogarive dhe raportet e ndërmjetme financiare të paaudituar për Projektin; d) rregullat e prokurimit, procedurat dhe dokumentet standarde të tenderit për projektin; e) treguesit e performancës që do të përdoren për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të Projektit;



dhe f) proceset përkatëse të identifikimit/kontrollit të menaxhimit të rrezikut mjedisor dhe social dhe mekanizmat e korigjimit të ankesave, siç manuali i përmendur mund të ndryshohet herë pas here me marrëveshjen e Bankës.

11. “PMT” nënkupton ekipin e menaxhimit të projektit të krijuar në përputhje me seksionin 4.01(b) dhe i referuar në seksionin IA2(i) në skedulën 2 të kësaj Marrëveshjeje, i kryesuar nga një Koordinator Projekti dhe i pajisur, *ndër të tjera*: me menaxherin e projektit, drejtuesit e komponentëve, specialistin e prokurimeve, specialistin e menaxhimit financiar, specialistin e masave mbrojtëse, pikën e kontaktit për Çështje Gjimore/Monitorim dhe Vlerësim dhe specialist teknik, si dhe staf në mbështetje të institucioneve/agjencive zbatuese dhe të përfituesve si pika kontakti për aktivitete të ndryshme, të gjitha në përputhje me POM-në.

12. “Rregulloret e prokurimit” nënkupton, për qëllimet e paragrafit 84 të Shtojcës së Kushteve të Përgjithshme, “Rregulloret e Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit IPF”, datë nëntor 2020.

13. “Sistemi SCADA” nënkupton sistemin e mbikëqyrjes, kontrollit dhe marrjes së të dhënave të elementeve të softuerit dhe harduerit që lejojnë kontrollin e proceseve dhe/ose marrjen e të dhënave në nivel lokal ose në vende të largëta.

14. “PIK të përzgjedhura” janë pikat e inspektimit kufitar, në: Bllatë, Kakavijë, Kapshticë, Qafëbotë, Qafëthanë dhe Vlorë, ose çdo zonë tjetër në territorin e Huamarrësit të përzgjedhur nga Huamarrësi, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes të përcaktuara në POM dhe të rëna dakord me Bankën.

15. “Rajone të zgjedhura” nënkupton rajonet e Tiranës, Shkodrës/Lezhës, Vlorës, Gjirokastrës, Beratit dhe Dibrës, ose çdo rajon tjetër në territorin e Huamarrësit të përzgjedhur nga Huamarrësi në marrëveshje me Bankën dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në POM.

16. “Data e nënshkrimit” nënkupton datën e mëvonshme nga dy datat në të cilat Huamarrësi dhe Banka nënshkruan këtë Marrëveshje dhe një përkufizim i tillë zbatohet për të gjitha referencat për “datën e Marrëveshjes së Huas” në Kushtet e Përgjithshme.

17. “Trajnim” nënkupton shpenzimet e kryera në lidhje me trajnimet dhe punëtoritë të lidhura me projektin, turet studimore, kurset e trajnimit, seminarët dhe aktivitetet e tjera të trajnimit siç është

rënë dakord me Bankën, përfshirë kostot e materialeve të trajnimit, marrjes me qira të objekteve dhe pajisjeve, udhëtimeve lokale, kostot e dietave të kursantëve dhe trajnerëve, si dhe shërbimet e interpretimit dhe të përkthimit.

DEKRET

Nr. 393, datë 27.12.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 98/2023, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit ‘Qëndrueshmëria ndaj klimës dhe zhvillimit të bujqësisë’”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM

Nr. 755, datë 20.12.2023

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2023, PËR DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA TË KRIJUARA ME LIGJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të tretë, të shkronjës “a”, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Akordimin e një fondi shtesë, në zërin e shpenzimeve korrente, në masën 1 000 000 000 (një miliard) lekë, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për pagesën e një pjese të diferencës së pagës së magjistratit, sipas arsytimit të vendimit nr. 35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese. Kjo diferencë jepet për institucionet e rivlerësimit kalimtar të



magjistratit, që nga momenti i krijimit të tyre dhe për institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë, që nga data 1 janar 2019 e në vazhdim.

2. Fondi, sipas pikës 1, ndahet, si më poshtë vijon:

a) Për institucionin e Prokurorisë së Përgjithshme shtohet fondi prej 400 000 000 (katërqind milionë) lekësh;

b) Për institucionin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë shtohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh;

c) Për institucionin e Këshillit të Lartë Gjyqsor shtohet fondi prej 350 000 000 (treqind e pesëdhjetë milionë) lekësh;

ç) Për institucionin e Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar shtohet fondi prej 60 000 000 (gjashtëdhjetë milionë) lekësh;

d) Për institucionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë shtohet fondi prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh;

dh) Për institucionin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit shtohet fondi prej 60 000 000 (gjashtëdhjetë milionë) lekësh;

e) Për institucionin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit shtohet fondi prej 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekësh;

ë) Për institucionin e Komisionerëve Publikë shtohet fondi prej 22 000 000 (njëzet e dy milionë) lekësh;

f) Për institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve shtohet fondi prej 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekësh;

g) Për institucionin e Avokatit të Popullit shtohet fondi prej 4 000 000 (katër milionë) lekësh;

gj) Për institucionin e Shkollës së Magjistraturës shtohet fondi prej 54 000 000 (pesëdhjetë e katër milionë) lekësh.

3. Fondi prej 1 000 000 000 (një miliard) lekësh përballohet nga fondi i kontingjencës, i miratuar në buxhetin e vitit 2023.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e përmendura në pikën 2 për zbatimin e këtij vendimi. Shlyerja e pagesës bëhet nga institucionet e sistemit të drejtësisë, brenda datës 15.1.2024.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 767, datë 20.12.2023

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 929, DATË 17.11.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË VEÇANTË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për përcaktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar, dhe të nenit 12, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 9, të vendimit nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen fjalët “... me përjashtim të 539 (pesëqind e tridhjetë e nëntë) pjesëtarëve të Forcave të Armatosura, që shpërblehen me 1 (një) pagë mujore, të 38 (tridhjetë e tetë) pjesëtarëve të Forcave të Armatosura, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, e të 7 (shtatë) personel zjarrfikës nga pushteti vendor në qytetet Korçë e Devoll, që shpërblehen me 2 (dy) paga mujore për rezultate të mira gjatë shuarjes së zjarreve brenda dhe jashtë vendit, si dhe të 1 255 (një mijë e dyqind e pesëdhjetë e pesë) personel zjarrfikës të pushtetit vendor, të angazhuar në shuarjen e zjarreve për vitin 2023, që shpërblehen me 1 (një) pagë mujore.”.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM

Nr. 787, datë 28.12.2023

**PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT
E SHQYRTIMIT TË NEVOJËS,
HARTIMIT, BASHKËPUNIMIT,
MIRATIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË
METODAVE APO TË SEKSIONEVE TË
REJA TË PLATFORMËS “ME TY PËR
SHQIPËRINË QË DUAM”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 18, të ligjit nr. 107/2021, “Për bashkëqeverisjen”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka si qëllim të përcaktojë:

a) rastet kur është i nevojshëm krijimi i metodave ose seksioneve të reja të platformës “Me ty për Shqipërinë që duam”, në vijim e quajtur “Platforma”, dhe procedurën që ndiqet për hartimin e miratimin e tyre;

b) rregullat për “Këshillimin Kombëtar”, qoftë si një instrument për krijimin e metodave të bashkëqeverisjes, ashtu edhe për zbatimin e qëllimeve të ligjit nr. 107/2021, “Për bashkëqeverisjen”.

2. Nisma për krijimin e metodave ose seksioneve të reja mund të ndërmerret nëse janë të pranishme këto rrethana apo kushte:

a) Nga ankesat/kërkesat e subjekteve në “Platformë”, nga të dhënat e marra në mënyrë direkte ose të tërthortë (deduktive) përmes “Këshillimit Kombëtar” apo nga veprimtaria e vetë institucioneve shtetërore konstatohen problematika me karakter të vazhdueshëm ose të përsëritshëm, të cilat, për shkak të specifikave, mund të adresohen në mënyrë më efektive nëpërmjet krijimit të metodave ose seksioneve të reja, të ndryshme nga ato ekzistuese;

b) Metoda ose seksioni i ri paraqet risi dhe përmirësime në drejtim transparencës ose shpejtësisë së ndërveprimit të subjektit me Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje (në vijim e quajtur “Agjencia”) dhe institucionet shtetërore.

II. PROCEDURAT PËR METODAT APO SEKSIONET E REJA

1. Krijimi i metodave ose seksioneve të reja të “Platformës” mund të nisë nga vetë Agjencia, me nismën e saj ose me propozimin e Kryeministrit, ministrit apo institucionit qendror që ka në përgjegjësi çështjet shtetërore, për të cilat kërkohet krijimi i metodës ose seksionit. Këto organe mund të mbështeten në nismën e tyre edhe nga “Këshillimi Kombëtar”, në mënyrë të drejtpërdrejtë, kur nevoja për krijim ose jo është pjesë e vetë këshillimit, apo në mënyrë të tërthortë, kur si rrjedhojë e informacionit të përftuar mbi çështjet e tjera, objekt këshillimi, deduktohet dhe argumentohet edhe nevoja për krijimin e metodës apo seksionit të ri të platformës.

2. Në rast të ndërmarrjes së nismës nga vetë Agjencia për të krijuar metodën apo seksionin e ri të “Platformës”, ajo mbështetet në:

a) konstatimet e saj nga të dhënat e administruara në “Platformë”;

b) informacionin e mbledhur nga veprimtaria inspektuese e Agjencisë, sipas kreut X, të ligjit nr. 107/2021, “Për bashkëqeverisjen”;

c) kërkesat e subjekteve përdoruese të “Platformës” për krijimin e metodave apo seksioneve të reja, nëse ka të tilla;

ç) informacionin e përftuar nga “Këshillimi Kombëtar”, qoftë si rrjedhojë e të dhënave të marra nga çështjet, objekt këshillimi, qoftë nëse krijimi i metodës apo seksionit është objekt këshillimi në vetvete.

3. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë, për nismën e tij të hartimit të metodës ose seksionit të ri të “Platformës”, njofton Kryeministrin, ministrin/at ose drejtuesit e institucioneve qendrore në fushën e përgjegjësisë të të cilave është çështja, për të cilën krijohet metoda apo seksioni i ri apo që preken nga krijimi i tij. Agjencia njofton, gjithashtu, edhe AKSHI-n, i cili ngarkohet të asistojë Agjencinë për zhvillimet në fushën e teknologjisë së informacionit, të nevojshme për krijimin dhe mbështetjen e metodës ose seksionit të ri.

4. Procesi i hartimit të metodës apo seksionit të ri nis me ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës, me urdhër të përbashkët të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë, drejtorit të përgjithshëm të AKSHI-t, si dhe të ministrit/ave apo drejtuesit/ve të institucionit/eve qendror/e, në varësi të fushës së përgjegjësisë përkatëse. Përveç përfaqësuesve të



kabineteve dhe nëpunësve civilë të ministrive apo të institucioneve qendrore, në veprimtarinë e grupit të punës mund të ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të kabinetit të Kryeministrit.

5. Grupi ndërinstitucional i punës përgatit një raport që përmban përshkrimin e:

a) parimit dhe mekanizmit të funksionimit të metodës ose seksionit që propozohet;

b) qëllimit dhe objektit të trajtimit të kësaj metode ose këtij seksioni;

c) argumentimit të rrethanave ose kushteve të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi;

ç) ndikimit që parashikohet të ketë metoda apo seksioni në drejtim të aksesit dhe përfshirjes së subjekteve, në përputhje me qëllimin dhe parimet e ligjit nr. 107/2021, “Për bashkëqeverisjen”;

d) zhvillimeve të nevojshme për krijimin e metodës ose seksionit të ri në fushën e teknologjisë së informacionit;

dh) shpenzimeve të nevojshme për krijimin e metodës ose seksionit;

e) identifikimit dhe përcaktimit të të dhënave parësore e dytësore, të nevojshme për krijimin e metodës ose seksionit të ri;

ë) në rastin ndërmarrjes së nismës si pasojë indirekte e të dhënave të përfuara nga “Këshillimi Kombëtar”, raporti përmban edhe argumentimin e nevojës së krijimit të metodës apo seksionit, bazuar në këto të dhëna.

6. Pas përfundimit të raportit, Agjencia harton projektvendimet e Këshillit të Ministrave për krijimin e metodës ose seksionit të ri në bazë të pikës 1, të nenit 18, të ligjit nr. 107/2021, “Për bashkëqeverisjen”, si dhe ndryshimet në bazën e të dhënave të “Platformës”, në bazë të pikës 4, të nenit 16, të të njëjtit ligj, dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”. Projektvendimet, së bashku me relacionet shpjeguese dhe raportin e hartuar nga grupi i punës, sipas pikës 7, të këtij vendimi, i përcillen Kryeministrit, për t’u proceduar, në përputhje me legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave.

III. RREGULLAT E KËSHILLIMIT KOMBËTAR

1. “Këshillimi Kombëtar” është një proces gjithëpërfshirës në kuadër të parimeve të bashkëqeverisjes për përmbushjen e objektit të mendimdhënies së publikut nëpërmjet mbledhjes së opinionit të qytetarëve mbi politikat, nismat,

vendimarrjen e Këshillit të Ministrave, si dhe mbi çështjet që lidhen me veprimtarinë e institucioneve të administratës shtetërore, në drejtim të dhënies së shërbimeve cilësore ndaj publikut.

2. “Këshillimi Kombëtar”, krahas qëllimit të përcaktuar në pikën 1, të këtij kreu, mund të shërbejë si shkak për ndërmarrjen e nismës për krijimin e metodave apo seksioneve të reja të Platformës në një nga këto mënyra:

a) Në mënyrë direkte, nëse krijimi ose jo i tyre bëhet shprehimisht objekt i “Këshillimit Kombëtar”;

b) Në mënyrë të tërthortë, kur si rrjedhojë e informacionit të përfuqar mbi çështjet e tjera, objekt këshillimi, deduktohet dhe argumentohet edhe nevoja për krijimin e metodës apo seksionit të ri të platformës.

3. “Këshillimi Kombëtar” kryhet nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, kryesisht me nismën e saj ose me nismën e Kryeministrit, kur vlerësohet e nevojshme prej tyre, jo më shpesh se dy herë në vit. Si rregull, nisma ndërmerret për çështjet që qeveria shqiptare kërkon të marrë mendimin e qytetarëve lidhur me politikat e qeverisjes dhe çështjet me rëndësi strategjike për vendin.

4. Mbledhja e opinionit të qytetarëve në kuadër të këtij procesi këshillimi kryhet nëpërmjet plotësimit nga ana e tyre të një pyetësori të hartuar nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, i cili shpërndahet në formatin fizik nga Posta Shqiptare sh.a., pranë adresave të tyre të banimit.

5. Pyetësori hartohet në bazë të çështjeve / pyetjeve për të cilat Kryeministri i ka komunikuar Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje nismën për zhvillimin e Këshillimit, ose të çështjeve/pyetjeve që kjo e fundit ka vlerësuar të përshtatshme me nismën e saj, pasi të ketë marrë miratimin e Kryeministrit për to.

6. Pas shpërndarjes së pyetësorit nga Posta Shqiptare, mënyrat e plotësimit dhe të përcjelljes së tij nga qytetarët janë:

a) Në versionin fizik (të printuar);

b) Në rrugë elektronike, nëpërmjet aksesimit *online* në faqen zyrtare përkatëse, të ngritur për këtë qëllim.

Plotësimi kryhet nga kryefamiljari dhe/ose anëtarë të familjes në moshë madhore.

7. Në rastin e përgjigjeve të pyetësorit të përcjella në rrugë elektronike nga qytetarët, AKSHI



mundëson kryerjen e procesit teknik të zhvillimit të “Këshillimit Kombëtar” në rrugë elektronike.

8. Plotësimi dhe përcjellja e pyetësorit të “Këshillimit Kombëtar”, në të dyja rastet e parashikuara në pikën 6 kryhen në mënyrë anonime.

9. Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje është institucioni përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e Këshillimit, në bashkëpunim me INSTAT-in dhe Postën Shqiptare sh.a. apo me çdo institucion publik tjetër të nevojshëm, sipas marrëveshjes kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional që lidhet midis tyre për kryerjen e fazave specifike të procesit, në përputhje me kuadrin ligjor institucional të secilit prej këtyre institucioneve.

10. Mbledhja e të dhënave të pyetësorit të “Këshillimit Kombëtar” kryhet për qëllime statistikore, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për statistikën zyrtare dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe shërben si mjet për të përmirësuar dhe jetësuar politikat qeverisëse.

11. Rezultatet e përgjigjeve të pyetësorit të programit të “Këshillimit Kombëtar” bëhen publike nëpërmjet publikimit në media dhe në faqen zyrtare të Këshillimit Kombëtar, brenda 4 (katër) javëve nga momenti i përfundimit të afatit për dërgimin e përgjigjeve të pyetësorit.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimi nr. 43, datë 1.2.2023, i Këshillit të Ministrave, “Për rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të nevojës, hartimit, bashkëpunimit, miratimit dhe funksionimit të metodave apo të seksioneve të reja të Platformës ‘Me ty për Shqipërinë që duam’”, shfuqizohet.

2. Fondi për përballimin e “Këshillimit Kombëtar” akordohet, rast pas rasti, në buxhetin vjetor të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, e cila e shpërndan tek institucionet bashkëpunuese, sipas preventivëve me shpenzimet përkatëse, bazuar në marrëveshjen kuadër ndërinstitucionale.

3. Ngarkohen ministritë, institucionet qendrore, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Posta Shqiptare sh.a. dhe INSTAT-i për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 793, datë 28.12.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 325, DATË 31.5.2023,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS SË
PAGAVE, NIVELEVE TË PAGAVE DHE
SHTESAVE TË TJERA MBI PAGË TË
ZËVENDËSMINISTRIT,
FUNKSIONARËVE TË KABINETEVE,
PREFEKTIT, NËNPREFEKTIT,
NËPUNËSVE CIVILË DHE
NËPUNËSVE NË DISA INSTITUCIONE
TË ADMINISTRATËS PUBLIKE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”; të shkronjës “h”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të neneve 7 e 9, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1, të kreut I, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në shkronjën “c”:

i. Emërtesa “Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave” zëvendësohet me “Agjencia e Inteligjencës Financiare”;



ii. Pas emërimit “Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve” shtohet “Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthëra”;

iii. Pas emërimit “Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve” shtohet “Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis-it*”.

b) Në shkronjën “ç”, pas emërimit “Agjencia Shtetërore për Shpronësim” shtohet “Qendra Rajonale e Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para (*EIT Raw Materials Regional Innovation Centre*)”.

2. Në kreun III bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 8/2, fjalët “Drejtoria e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave” zëvendësohen me “Agjencinë e Inteligjencës Financiare”;

b) Pas pikës 8/5 shtohet pika 8/6, me këtë përmbajtje:

“8/6. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve në Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis-it* janë sipas lidhjes nr. 9/6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

c) Pas pikës 9/10 shtohet pika 9/11, me këtë përmbajtje:

“9/11. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve në Qendrën Rajonale të

Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para (*EIT Raw Materials Regional Innovation Centre*) janë sipas lidhjes nr. 10/11, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

3. Në lidhjen nr. 9, pas fjalëve “specialist në njësitë organizative të përmbajtjes në Agjencinë Telegrafike Shqiptare” shtohen “specialist në njësitë organizative të përmbajtjes në Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthëra.”.

4. Në titullin e lidhjes nr. 9/2, fjalët “Drejtoria e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave” zëvendësohen me “Agjencinë e Inteligjencës Financiare”.

5. Në lidhjen nr. 12, pas fjalëve “përgjegjës sektori në zyrat vendore të arsimit parauniversitar” shtohen “specialist në zyrat rajonale të Avokatit të Popullit”.

II. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga data e emërimit të nëpunësit në detyrë dhe për vitin 2023 përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 9/6

Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve në Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis-it*

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës	Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj)
Titullar i institucionit	I-3	1	20 000
Drejtor i drejtorive të përmbajtjes; Koordinator.	II-1	1	15 000
Drejtor i drejtorive mbështetëse.	II-2	1	0
Përgjegjës i sektorëve të përmbajtjes.	III-1	1	14 000
Përgjegjës i sektorëve mbështetës.	III-2	1	0
Specialist në sektorët apo drejtoritë e përmbajtjes.	IV-1	1 ose 2	14 000
Specialist në sektorët apo drejtoritë mbështetëse.	IV-2	1 ose 2 ose 3	0
	IV-3		0



Lidhja nr. 10/11

Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve në Qendrën Rajonale të Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para (*EIT RawMaterials Regional Innovation Centre*)

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës	Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj)
Titullar i institucionit	I-4	1	70 000
Ekspertë	II-1	1	50 000

VENDIM

Nr. 794, datë 28.12.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 555, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT MJEKËSOR, TË PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË DHE TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT TEKNIK TË SHKENCAVE MJEKËSORE, NË SISTEMIN E MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR SHËNDETËSINË, NË NJËSINË MJEKËSORE USHTARAKE PRANË SPITALIT UNIVERSITAR TË TRAUMËS, NË STRUKTURAT E TJERA TË FORCAVE TË ARMATOSURA DHE NË INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE DHE SPITALIN PËRKATËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat

e tjera të Forcave të Armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 2 bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në shkronjën “a”, pas fjalëve “... në spitalet e nivelit terciar ...” shtohen “... në qendrat spitalore rajonale ...”.

b) Pas shkronjës “j” shtohet shkronja “k”, me këtë përmbajtje:

“k) personeli mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi” janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.11, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Në kërret e lidhjes nr. 1 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në kreun 1/AP bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

i. Në titullin e kreut, pas fjalëve “... në spitalet e nivelit terciar ...” shtohen “... në qendrat spitalore rajonale ...”;

ii. Në rreshtat me numrat rendorë 2, 5 dhe 9, emërtimi “Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë” zëvendësohet me “Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”.”;

iii. Në rreshtat me numrat rendorë 10, 11, 13 dhe 17, pas fjalëve “... në spitalet universitare ...” shtohen “... në Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”...”;

iv. Në rreshtin me numrin rendor 4 shtohet emërtesa “Konsulent mjekësor në spitalet universitare dhe terciare.”.

b) Në kreun 1.1 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i. Në rreshtin me numrin rendor 16, emërtesa “Farmacist” hiqet;

ii. Pas rreshtit me numrin rendor 18 shtohen rreshtat me numrat rendorë 19 dhe 20, me këtë përmbajtje:



19.	Fizikan në Radioterapi/Radiokirurgji/Mjekësi nukleare	1	2%		90 600	3 700
20.	Mjek i përgjithshëm në urgjencë/Farmacist	1	2%		90 600	2 500

c) Në pjesën e dytë, “II. Në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor”, të kreut 1.2, pas rreshtit me numrin rendor 14 shtohen rreshtat me numrat rendorë 15, 16 dhe 17, me këtë përmbajtje:

15.	Shef shërbimi (mjek mikrobiolog) që punon në shërbimet e shëndetit publik.	1	2%		127 000	
16.	Përgjegjës/shef në shërbimet e shëndetit mendor me shtretër dhe shërbimet komunitare (punonjës social/psikolog).	1	2%		82 600	5 000
17.	Mjek mikrobiolog që punon në shërbimet e shëndetit publik.	1	2%		118 200	7 000

ç) Në kreun 1.6, vlera e elementit “Shtesë për pozicion” për emërtesën “Drejtor” bëhet 128 000.

d) Pas kreut 1.10 shtohet kreu 1.11, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Në lidhjen nr. 2, pas kreut 2.7 shtohet kreu 2.8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

II. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2023 përballohen nga fondet e miratuara për pagat dhe shpenzimet e tjera të personelit, në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale dhe të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për vitin 2023.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 shtator 2023.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

Lidhja nr. 1 (kreu 1.11)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë, në Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”

EMËRTIMI		PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2		3	4
1	Shef shërbimi në shërbimin universitar/terciar	1	2%		159 800	
2	Përgjegjës njësie/klinike/kabineti (mjek me specialitet) në shërbimin universitar/terciar	1	2%		145 700	
3	Përgjegjës njësie/klinike në Reanimacion	1	2%		145 700	3 700
4	Shef shërbimi në shërbimet e tjera(mjek me specialitet)	1	2%		136 900	
5	Mjekë me specialitet në shërbimet: Reanimacion/Radiologji/Hemodinamikë/Urgjencë	1	2%		134 600	3 700
6	Mjekë me specialitet në shërbimet Kirurgji/Pneumologji/Laborator/ Hematologji	1	2%		134 600	2 000
7	Mjek me specialitet në shërbimin universitar/terciar	1	2%		134 600	
8	Përgjegjës njësie/klinike/kabineti në shërbimet e tjera	1	2%		124 000	
9	Mjekë me specialitet në shërbimet: Pediatri/Neonatologji	1	2%		118 300	3 700



10	Mjekë me specialitet në shërbimet: Obstetrikë-Gjinekologji/Laborator klinik biokimik	1	2%		118 300	2 000
11	Mjekë me specialitet në shërbimet e tjera	1	2%		118 300	
12	Shef/Përgjegjës farmacie	1	2%		93 500	5 000
13	Mjek i përgjithshëm në urgjencën paraspitalore Farmacist	1	2%		90 600	2500
14	Psikolog/Punonjës Social/Specialist i shëndetit publik. Fizikan/Biolog në shërbimin universitar/terciar	1	2%		90 600	
15	Shef/Përgjegjës njësie/Klinike (mjek i përgjithshëm)	1	2%		79 200	
16	Psikolog/Punonjës social në shërbimet e tjera	1	2%		73 100	

Lidhja nr. 2 (kreu 2.8)

**Struktura dhe nivelet e pagave për personelin teknik të shkencave mjekësore në Qendrën Spitalore
Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”**

EMËRTIMI		PAGA MUJORE				
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)		Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2		3	4
1	Kryeinfermier i përgjithshëm		2%		63 600	8 000
2	Kryeinfermier shërbimi në anestezi-reanimacion		2%		63 600	3 400
3	Kryeinfermier në shërbimin e urgjencës Infermier në hemodinamikë Kryelaborant bakteriolog Kryeinfermier në Shërbimet e kirurgjisë/në sallën e operacionit Kryeinfermier njësie/klinike në Fizioterapi		2%		63 600	1 800
4	Kryeinfermier në shërbimet universitare/terciar		2%		63 600	
5	Kryeinfermier në shërbimet e tjera		2%		60 400	
6	Kryelaborant imazherie		2%		60 600	1 800
7	Kryelaborant në Laboratorin Klinik Biokimik, Bakteriologjik. Kryeinfermier në Kirurgji/ Reanimacion/Sallë operacioni/Obstetrike/Gjinekologji		2%		60 600	1 500
8	Laborant histopatolog/Infermier në Reanimacion		2%		60 400	3 400
9	Infermier në punktin e gjakut. Infermier radiologji/endoskopi/teknik imazherie Infermier në kirurgji/Infermier salle		2%		53 300	1 800
10	Infermier pranirum urgjence (njësia e koordinimit të urgjencës) Infermier në pneumologji/fizioterapi		2%		51 100	1 800
11	Teknik laborator/Logoped/Fizioterapist Infermier në shërbimet terciare Infermier/mami në obstetrike/gjinekologji Infermier në pediatri		2%		51 100	1 500
12	Infermier në shërbimet e tjera		2%		51 100	
13	Kujdestar		2%		45 000	



VENDIM
Nr. 796, datë 28.12.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 326, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PAGAT E
PUNONJËSVE MBËSHTETËS DHE
PUNONJËSVE TË TJERË TË
SPECIALITETEVE TË NDRYSHME NË
DISA INSTITUCIONE TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë

minimale në shkallë vendi”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Kreu 1/4, i vendimit nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, zëvendësohet me kreun nr. 1/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 prill 2023.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Kreu I/ 4

Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë të punonjësve të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të punonjësve të Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Nr. rendor	Emërtimi i pozicionit	Klasa e pagës
1	Oficer informacioni dhe i ruajtjes së rendit; Oficer informacioni në Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Sekretar; Ndihmës (sekretari – protokoll); Punonjës i postës sekrete.	VII
2	Shofer drejtuesi në Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Teknik mirëmbajtjeje; Operator; Magaznier.	VI
3	Shofer i postës sekrete; Kuzhinier në Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Shofer prokurori në Prokurorinë e Posaçme.	V
4	Shoferë të tjerë të institucionit.	IV
5	Punonjës pastrimi.	II

Shënim. Për emërtesat e pozicioneve të punës, klasat e të cilave nuk janë përcaktuar në këtë lidhje, përdoret kreu I/1.



VENDIM

Nr. 799, datë 28.12.2023

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 465, DATË 26.7.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E TASK-FORCËS PËR PËRMIRËSIMIN E NIVELIT TË KONTROLLIT TË MJETEVE MOTORIKE E RIMORKIOVE TË TYRE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 88, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 465, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 7, togfjalëshi “... 31 dhjetor 2023.” zëvendësohet me “... 31 dhjetor 2024.”.

b) Pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5, të aneksit I, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Pagesa e drejtuesit të Task-Forcës barazohet në pagë me nëpunësin civil të klasës I-4.

2. Pagesa e anëtarëve të Task-Forcës barazohet në pagë me nëpunësin civil të klasës II-1.

3. Pagesa e shefit të grupit të Task-Forcës barazohet në pagë me nëpunësin civil të klasës III-1.

4. Pagesa e specialistit të grupit të Task-Forcës barazohet në pagë me nëpunësin civil të klasës IV-1.

5. Pagesa e sekretarit/sekretares të/së drejtuesit të Task-Forcës barazohet me pagën minimale në shkallë vendi.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 801, datë 28.12.2023

PËR NJË SHITESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 571, DATË 6.10.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË 35 NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN, BASHKIA MIRDITË, NË KUADËR TË MARRËVESHJES SË GRANTIT TË LIDHUR, NDËRMJET AGJENCISË SË ZHVILLIMIT AUSTRIAK (ADA) DHE MINISTRI TË SHETIT PËR RINDËRTIMIN, PËR PROJEKTIN ‘PËRGJIGJE NDAJ TËRMETEVE NË SHQIPËRI’”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nëndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 571, datë 6.10.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në pikën 2, vlera “... 129 087 000 (njëqind e njëzet e nëntë milionë e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë ...” zëvendësohet me “... 121 743 141 (njëqind e njëzet e një milionë e shtatëqind e dyzet e tre mijë e njëqind e dyzet e një) lekë ...”;

b) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, i transferohet fondi në masën 7 343 859 (shtatë milionë e treqind e dyzet e



tre mijë e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 803, datë 28.12.2023

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR
AUTORITETIN E KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE,
PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 117, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e

Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), për vitin 2024, në shumën 393 000 000 (treqind e nëntëdhjetë e tre milionë lekë), sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PASQYRA NR. 1

**PLANI I SHPENZIMEVE TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE
POSTARE, PËR VITIN 2024**

Nr.	Të ardhurat	Në lekë	Shpenzimet	Në lek
1	Të ardhura nga pagesa për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike	178 000 000	Shpenzime për paga dhe shtesa të tjera	152 061 913
2	Të ardhura nga pagesa për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike	111 800 000	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	21 502 147
3	Të ardhura nga pagesa për numeracion	26 500 000	Shpenzime për materiale	9 000 000
4	Të ardhura nga pagesa për koston e shërbimit të portabilitetit të numrit	31 600 000	Shpenzime për shërbime	162 589 750
5	Të ardhura nga mbikëqyrja e tregut të shërbimit postar	12 000 000	Shpenzime për investime	47 846 190
6	Të ardhura nga pagesa për domain	9 500 000		
7	Të ardhura nga pagesa dhe të ardhura të tjera	100 000		
8	Të ardhura nga komisioni nga agjenti tatimor	23 500 000		
	Totali i të ardhurave	393 000 000		393 000 000



VENDIM
Nr. 804, datë 28.12.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 750, DATË 1.12.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE PËR VITIN 2023”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 117, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër

i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pasqyra nr. 1, bashkëlidhur vendimit nr. 750, datë 1.12.2022, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me pasqyrën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Pasqyra nr. 1

PLANI I SHPENZIMEVE TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE, PËR VITIN 2023

Të ardhura	Në mijë lek	Shpenzime	Në mijë lek
Të ardhura nga mbikëqyrja e tregut të komunikimeve elektronike	159,000	Shpenzime për paga dhe shtesa të tjera	132,630
Të ardhura nga pagesa për caktimin dhe përdorimin e frekuencave	126,000	Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	18,012
Të ardhura nga pagesa për numeracionin	26,000	Shpenzime për materiale	6,550
Të ardhura nga pagesa për koston e shërbimit të portabilitetit të numrit	19,400	Shpenzime për shërbime	148,404
Të ardhura nga mbikëqyrja e tregut të shërbimit postar	9,500	Shpenzime për investime	75,904
Të ardhura nga pagesa për domain	6,900		
Të ardhura nga pagesa dhe të ardhura të tjera	200		
Të ardhura nga Komisioni nga agjenti tatimor	24,500		
Total i të ardhurave	381,500	Totali shpenzimeve	381,500

**VENDIM****Nr. 805, datë 28.12.2023**

**PËR PËRCAKTIMIN E STATUSIT,
MËNYRAVE TË PJESËMARRJES DHE
MASËS SË DIETËS DITORE PËR
VËSHITRËSI SHËRBIMI TË
PERSONELIT TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË MISIONIN E
KOMBEVE TË BASHKUARA NË ABYEI
(UNISFA)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 2 e 5, të nenit 6, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit”, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “b”, të nenit 3, të aktit normativ nr. 4, datë 20.6.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin e Kombeve të Bashkuara në *Abyei* (UNISFA)”, miratuar me ligjin nr. 59/2023, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pjesëmarrja e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin e Kombeve të Bashkuara në *Abyei*, në kufirin midis Sudanit dhe Sudanit të Jugut, do të ketë një kohëzgjatje prej 3 (tre) vjetësh, me rotacion deri në 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditë. Afati i misionit fillon të llogaritet nga data e dërgimit në mision. Periudhës së qëndrimit në mision i shtohen edhe ditët e qëndrimit për marrje e dorëzim detyrë dhe të vonesave të transportit strategjik për ndërrimin me personelin e radhës.

2. Statusi i personelit të Forcave të Armatosura në këtë mision është sipas Marrëveshjes së Statusit të Forcave (SOFA), të datës 20 nëntor 2012, ndërmjet Organizatës së Kombeve të Bashkuara

(OKB) dhe qeverisë së Republikës së Sudanit të Jugut.

3. Ministria e Mbrojtjes, për personelin pjesëmarrës në këtë mision, përballon shpenzimet, për:

a) dietat për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagesë mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) transportimin për në atdhe të individëve të shkëputur të misionit në rast vdekjeje, sëmundjeje, pamundësie për të përfunduar misionin ose thyerjeje disipline;

ç) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së misionit.

4. Transportimi për në atdhe i individëve të shkëputur nga misioni në rast vdekjeje, sëmundjeje, pamundësie për të përfunduar misionin ose thyerjeje disipline përballohet nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, përveç rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy- ose shumëpalëshe, ku pala/palët tjetër/e tjera merr/marrin përsipër përballimin e këtyre shpenzime.

5. Ministria e Mbrojtjes bën sigurimin e jetës për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët marrin pjesë në këtë mision.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

7. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e dërgimit të personelit në mision.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 808, datë 28.12.2023**

**PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË
PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE TË
GARDËS SË REPUBLIKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Numri i përgjithshëm i punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë është 1 505 (një mijë e pesëqind e pesë) veta.

2. Vendimi nr. 445, datë 22.5.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës e të limitit organik dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë në Gardën e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Garda e Republikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet më 1 janar 2024.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 809, datë 28.12.2023

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 597, DATË 13.10.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PERSONALITETEVE DHE OBJEKTEVE TË TJERA QË RUHEN DHE MBROHEN NGA GARDA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 12, pika 1, shkronja “d”, dhe pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 597, datë 13.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e personaliteteve dhe objekteve të tjera që ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në shkronjën “g”, të pikës 1, fjalët “ ... dhe Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit;” zëvendësohen me “... , Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit, gjyqtarët e gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe prokurorët e Prokurorisë së

Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; ...”.

2. Në shkronjën “b”, të pikës 2, pas nënndarjes “iv” shtohen nënndarjet “v” dhe “vi” me këtë përmbajtje:

“v. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;

vi. Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.”.

II. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 810, datë 28.12.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 478, DATË 10.7.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURËN E SIGURISË SË GJYQTARËVE TË GJYKATAVE KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR, TË PROKURORËVE TË PROKURORISË SË POSAÇME DHE DREJTORIT TË BYROSË KOMBËTARE TË HETIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 47, të ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 478, datë 10.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurën e sigurisë së gjyqtarëve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas fjalisë së parë, të pikës 2, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Mbrojtja personale mund të ofrohet edhe në bazë të kërkesës së thjeshtë të paraqitur, sipas rastit,



nga kryetari i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Kryetari i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ose Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.”.

2. Në pikën 3 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Togfjalëshi “oficer nënoficer” zëvendësohet me fjalët “... truprojë të nivelit bazë dhe truprojë të nivelit të mesëm ...”;

b) Në fund të pikës shtohen fjalët “... gjatë kohëzgjatjes së mandatit dhe për një afat jo më shumë se 2 vjet pas përfundimit të tij.”.

3. Pas pikës 3 shtohen pikat 3/1 dhe 3/2, me këtë përmbajtje:

“3/1. Mbrojtja personale e gjyqtarëve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme garantohet me shoqërim me një truprojë të nivelit të mesëm.

3/2. Në raste të veçanta dhe me kërkesë të tyre, subjekteve të parashikuara në pikën 3, gjatë vizitave zyrtare jashtë vendit u garantohet shoqërimi me truprojë të nivelit të mesëm.”.

4. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Masat shtesë për mbrojtjen e veçantë personale të familjes dhe pasurisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokurorisë së Posaçme në rast të rrezikut për jetën, shëndetin e tij/saj ose familjes dhe pasurisë përcaktohen dhe jepen sipas rregullave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për mbrojtjen e veçantë të magistratit.”.

5. Në pikën 8, pas fjalëve “... një përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit ...” shtohen “... një përfaqësues nga Garda e Republikës së Shqipërisë ...”.

6. Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“12. Truprojat e gjyqtarëve, prokurorëve, familjeve dhe banesave të tyre caktohen dhe zëvendësohen vetëm pasi të jetë marrë, paraprakisht, miratimi i kryetarit të Gjykatës, drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme apo drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit.”.

II. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, kryetarët e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit, Garda e Republikës së

Shqipërisë dhe Policia e Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 813, datë 28.12.2023

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 531, DATË 7.9.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË AKSIONARE SHTETËRORE “OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA” SHA, PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË VEÇANTA TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 105, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 531, datë 7.9.2023, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 20 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“20. Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara (ASHPP) do të vijojë të kryejë procedurat e veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë deri në fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së Organit të Blerjeve të Përqendruara sh.a. (OBP).”.

b) Në pikën 21, fjalia e parë riformulohet, si më poshtë vijon:

“Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a. njofton me shkrim institucionet e përcaktuara në pikën 5, të këtij vendimi, për datën e fillimit të ushtrimit të veprimtarisë, datë e cila përcaktohet me urdhër të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.”.



c) Në pikën 23, fjalët “Me mbylljen e ushtrimit të veprimtarisë së ASHPP-së, sipas këtij vendimi ...” zëvendësohen me “Me fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së OBP sh.a. ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia e Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 815, datë 28.12.2023

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe të

nenit 5, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 3, të kreut I, pas fjalëve “... (CFSP) 2023/848 ...” shtohen “... (CFSP) 2023/2231 ...”.

2. Në aneksin 3, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2023/2231, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe në pikën 1, të nenit 7, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



2023/2231

24.10.2023

VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2023/2231

i datës 23 tetor 2023

për ndryshimin e Vendimit (CFSP) 2016/1693 në lidhje me masat kufizuese kundër ISIL (Da'esh) dhe Al-Queda-s dhe personave, grupeve, sipërmarrjeve dhe subjekteve të lidhura me ta

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikën e Punëve të Jashtme dhe të Sigurisë,

Duke marrë në konsideratë se:

- (1) Më 20 shtator 2016, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2016/1693 ⁽¹⁾.
- (2) Masat kufizuese të përcaktuara në Vendimin (CFSP) 2016/1693 zbatohen deri më 31 tetor 2023.
- (3) Vendimi (CFSP) 2016/1693 përmban një kërkesë për rishikimin e masave kufizuese të përcaktuara aty në intervale të rregullta dhe të paktën çdo 12 muaj. Në bazë të rishikimit të atij Vendimi, masat kufizuese duhet të zgjaten deri më 31 tetor 2024.
- (4) Vendimi (CFSP) 2016/1693 duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM

Neni 1

Në nenin 6 të Vendimit (CFSP) 2016/1693, paragrafi 6 zëvendësohet si vijon:

'6. Masat e përmendura në nenin 2(2) dhe nenin 3(3) dhe (4) do të zbatohen deri më 31 tetor 2024.' '6.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi një ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Në Luksemburg, 23 tetor 2023.

*Për Këshillin**Presidenti*

J. BORRELL FONTELLES

⁽¹⁾ Vendimi i Këshillit (CFSP) 2016/1693 i datës 20 shtator 2016 në lidhje me masat kufizuese kundër ISIL (Da'esh) dhe Al-Queda-s dhe personave, grupeve, ndërmarrjeve dhe subjekteve të lidhura me ta dhe shfuqizimin e Pozicionit të Përbashkët 2002/402/CFSP (OJ L 25, 21.9.2016, f. 25).



2023/2231

24.10.2023

COUNCIL DECISION (CFSP) 2023/2231

of 23 October 2023

amending Decision (CFSP) 2016/1693 concerning restrictive measures against ISIL (Da'esh) and Al-Qaeda and persons, groups, undertakings and entities associated with them

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 20 September 2016, the Council adopted Decision (CFSP) 2016/1693 ⁽¹⁾.
- (2) The restrictive measures set out in Decision (CFSP) 2016/1693 apply until 31 October 2023.
- (3) Decision (CFSP) 2016/1693 contains a requirement to review the restrictive measures set out therein at regular intervals and at least every 12 months. On the basis of a review of that Decision, the restrictive measures should be extended until 31 October 2024.
- (4) Decision (CFSP) 2016/1693 should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

In Article 6 of Decision (CFSP) 2016/1693, paragraph 6 is replaced by the following:

'6. The measures referred to in Article 2(2) and Article 3(3) and (4) shall apply until 31 October 2024.'

Article 2

This Decision shall enter into force on the day following that of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Luxembourg, 23 October 2023.

For the Council
The President

J. BORRELL FONTELLES

⁽¹⁾ Council Decision (CFSP) 2016/1693 of 20 September 2016 concerning restrictive measures against ISIL (Da'esh) and Al-Qaeda and persons, groups, undertakings and entities associated with them and repealing Common Position 2002/402/CFSP (OJ L 255, 21.9.2016, p. 25).

**VENDIM****Nr. 819, datë 28.12.2023****PËR SHPËRBLIMIN E KATEGORISË SË
PERSONAVE QË PËRFITOJNË
PENSION INVALIDITETI DHE
PENSION FAMILJAR, PËR VITIN 2023**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë, të personave që përfitojnë pension invaliditeti dhe pension familjar, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për vitin 2023.

2. Të drejtën për të përfituar shpërblimin, në masën e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, e kanë edhe ata persona të cilëve iu lind e drejta për përfitimin e pensionit deri në datën 31.12.2023, përfshirë edhe këtë datë, dhe kanë të drejtë ta marrin vetëm një herë këtë shpërblim.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 560 473 000 (pesëqind e gjashtëdhjetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e tre mijë), e ndarë në 556 025 000 (pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë milionë e njëzet e pesë mijë) lekë për shpërblimin dhe 4 448 000 (katër milionë e katërqind e dyzet e tetë mijë) lekë shpenzime administrative për dhënien e shpërblimit. Efektet financiare përballohen nga “Fondi i kontingjencës”, i miratuar në buxhetin e vitit 2023 dhe buxheti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2023.

4. Shpërblimet kalohen në llogaritë e pensionistëve në muajin dhjetor 2023 dhe paguhen gjatë këtij muaji. Në rastet kur pagesat efektive nuk kryhen brenda muajit dhjetor 2023, ato do të paguhen gjatë vitit 2024. Shpërblimi i patërhequr parashkruhet pas datës 31.12.2024.

5. Administrimi i fondeve buxhetore të shpërblimit të pensionistëve, caktimi i shpërblimit për çdo përfitues dhe pagesa realizohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore e Posta Shqiptare sh.a. dhe bankat e nivelit të dytë, sipas të njëjtave procedura,

që zbatohen për administrimin e fondit të sigurimeve shoqërore.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi, të cilat autorizohen të kryejnë edhe rialokimin e fondeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama****VENDIM****Nr. 822, datë 28.12.2023****PËR FINANCIMIN E FEDERATËS
SHQIPTARE TË FUTBOLLIT, PËR
MBËSHTETJEN E EKIPIT KOMBËTAR
TË FUTBOLLIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin, në masën 200 000 000 (dyqind milionë) lekë, të Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF), për mbështetjen e Ekipit Kombëtar të Futbollit, në kuadër të UEFA EURO 2024.

2. Fondi i përcaktuar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, transferohet në llogarinë e FSHF-së në bankën e nivelit të dytë “Union Bank” sh.a., me numër llogarie 111141628020115, dhe përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2023 për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, përkatësisht, në llogarinë ekonomike 604 “Transferata të brendshme”, në programin buxhetor 08140 “Zhvillimi i sportit”.

3. FSHF-ja, brenda muajit mars 2024, paraqet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dokumentacionin justifikues/transfertat bankare për shpërndarjen e fondit sipas veprimtarisë për të cilën do të përdoret ky fond.



4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Federata Shqiptare e Futbollit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 824, datë 28.12.2023

**PËR NJË SHITESË DHE NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 288,
DATË 10.4.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E
MASËS DHE TË PROCEDURËS SË
DHËNIES SË NDIHMËS SË
MENJËHERSHME FINANCIARE PËR
FOSHNJAT E PORSALINDURA DHE
MËNYRËN E BASHKËPUNIMIT,
NDËRMJET INSTITUCIONEVE TË
SHËRBIMIT SPITALOR DHE ATYRE
TË GJENDJES CIVILE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 288, datë 10.4.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pika 1, e kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Ndihmën e menjëhershme financiare (bonus) sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, e përfitojnë:

a) prindi/prindërit e foshnjës së porsalindur, shtetas shqiptarë, të cilët jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të paktën 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë kalendarike të vitit paraardhës, sipas të dhënave të sistemit TIMS dhe të regjistruar sipas afateve ligjore të përcaktuara në ligjin për gjendjen civile.

b) prindi/prindërit me shtetësi tjetër, të cilët janë rezidentë të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë, të cilëve nga shteti shqiptar u është dhënë statusi i refugjatit, i mbrojtjes plotësuese ose i azilkërkuesit dhe vendosin t’i japin foshnjës shtetësi shqiptare, sipas ligjit për shtetësinë shqiptare, dhe e regjistrojnë si shtetas shqiptar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.”.

b) Në kreun III, pas pikës 26 shtohet pika 26/1, me këtë përmbajtje:

“26/1. Për përfitimin e ndihmës së menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura, në çdo rast, prindi/prindërit, krahas dokumentacionit të përcaktuar në këtë vendim, paraqesin edhe formularin e vetëdeklarimit, që jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

c) Në fund të vendimit shtohet aneksi nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



Aneks nr. 1

FORMULAR I VETËDEKLARIMIT

Të dhënat e vetëdeklaruesit

Emër Mbiemër	
Atësia/ Amësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokumenti i identifikimit (një kopje bashkëngjitur formularit)	

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jetoj pa ndërprerje në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta.

Shërbimi Social Shtetëror autorizohet të verifikojë të dhënat e sistemit TIMS për vitin paraardhës, lëshuar nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit, që vërteton se 180 ditë kalendarike, kam qenë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

DEKLARUESI

MARRËSI I VETËDEKLARIMIT

Emër Mbiemër/firmë

Emër Mbiemër/firmë

VENDIM

Nr. 832, datë 28.12.2023

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 422, DATË 6.5.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRBËRJEN, RREGULLAT E FUNKSIONIMIT DHE TRAJTIMIN FINANCIAR TË GRUPIT NEGOCIATOR DHE DETYRAT E KRYENEGOCIATORIT PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE TË ADERIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe të vendimit nr. 749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, me propozimin e ministrit të Shtetit dhe Kryenegociatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të kreut I, të vendimit nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Fjalët “Znj. Albana Koçiu” zëvendësohen me “Znj. Enkela Dudushi”;

b) Fjalët “Z. Ilir Beqaj” zëvendësohen me “Znj. Jona Suli”;

c) Fjalët “Z. Ervin Mete, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, negociator për kapitullin 9,” zëvendësohen me “Znj. Mimoza Kaçi, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, negociator në detyrë për kapitullin 9, deri në emërimin e drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv”;

2. Ngarkohen ministri i Shtetit dhe Kryenegociatori, dhe grupi negociator për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

Faqe | 23793

**VENDIM****Nr. 834, datë 28.12.2023****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 929, DATË 17.11.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË VEÇANTË”, TË NDRYSHUAR, DHE PËR SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2023, MIRATUAR PËR DISA INSTITUCIONE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për përcaktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 12 e 14, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 9, e vendimit nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Për vitin 2023, fondi i veçantë i institucioneve qendrore buxhetore dhe jobuxhetore, institucioneve të vetëqeverisjes vendore, njërive të fondeve speciale, institucioneve publike të krijuara me ligj të posaçëm, ndërmarrjeve me kapital mbi 50% shtetëror, në varësi të institucioneve qendrore dhe vetëqeverisjes vendore nuk përdoret për veprimtari social-kulturore dhe shpërblimin e punonjësve. Ky përcaktim nuk zbatohet, për:

a) punonjësit mbështetës dhe punonjësit e tjerë të specialiteteve të ndryshme, të cilët paguhen me sistemin me 9 dhe 13 klasa, organikë dhe me kontratë të përkohshme mbi 6 muaj, në njësitë e qeverisjes qendrore, të cilët shpërblehen në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

b) punonjësit e Policisë së Burgjeve, si dhe punonjësit e tjerë civilë të sistemit të burgjeve, përfshirë edhe punonjësit e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve, për të cilët masa e shpërblimit nuk tejkalon nivelin e një page mujore;

c) punonjësit e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, të cilët shpërblehen deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

ç) punonjësit e institucioneve të rivlerësimit kalimtar;

d) 539 (pesëqind e tridhjetë e nëntë) pjesëtarë të Forcave të Armatosura që shpërblehen me 1 (një) pagë mujore dhe 38 (tridhjetë e tetë) pjesëtarë të Forcave të Armatosura, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile e 7 (shtatë) personel zjarrfikës nga pushteti vendor në qytetet Korçë e Devoll që shpërblehen me 2 (dy) paga mujore;

dh) 1 255 (një mijë e dyqind e pesëdhjetë e pesë) punonjës, personel zjarrfikës i pushtetit vendor, angazhuar në shuarjen e zjarreve për vitin 2023, që shpërblehen me 1 (një) pagë mujore, sipas listës për çdo bashki, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Efektet financiare për shpërblimin e punonjësve të sipërpërmendur përballohen nga:

- fondet e lira në zërin e shpenzimeve të personelit të njësisë dhe nga fondi i veçantë, për punonjësit sipas shkronjës “a”;

- fondi rezervë i buxhetit, në masën 380 000 000 (treqind e tetëdhjetë milionë) lekë për punonjësit sipas shkronjës “b”. Ky fond shtohet në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë, miratuar për vitin 2023, në zërin shpenzime personeli për programin “Sistemi i burgjeve”;

- fondet e institucionit të miratuara për vitin 2023, për punonjësit sipas shkronjës “c”;

- fondet e lira në zërin e shpenzimeve të personelit të institucionit, të miratuara për vitin 2023, për punonjësit sipas shkronjave “ç” dhe “d”.

- fondi rezervë i buxhetit, në masën 83 400 000 (tetëdhjetë e tre milionë e katërqind mijë) lekë, për punonjësit sipas shkronjës “dh”. Ky fond shtohet në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes, miratuar për vitin 2023, në zërin shpenzime korrente për programin “Emergjencja civile”.

3. Komisionit të Pavarur të Kualifikimit i shtohet fondi prej 40 000 000 (dyzet milionë) lekësh, në zërin e shpenzimeve të personelit, në buxhetin e miratuar për vitin 2023. Ky fond përballohet nga fondi rezervë i buxhetit dhe përdoret për pagesën e diferencës së pagës së magistratit, sipas arsyetimit të bërë nga Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 35/2022.

4. Ngarkohen institucionet e përmendura në këtë vendim të kryejnë veprimet financiare për zbatimin e këtij vendimi deri në datën 15.1.2024.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



STRUKTURAT E MZSH-SË QË JANË ANGAZHUAR NË ZJARRE		
Bashkia/DPMZSH	Nr Personeli	Fondi / lekë
DPMZSH	9	615,000
KORÇË	30	1,980,000
DEVOLL	14	940,000
KOLONJË	16	1,070,000
MALIQ	14	940,000
PUSTEC	14	940,000
POGRADEC	18	1,200,000
ELBASAN	25	1,655,000
GRAMSH	16	1,070,000
LIBRAZHD	15	1,005,000
PRRENJAS	14	940,000
PEQIN	14	940,000
CËRRIK	13	875,000
BELSH	12	810,000
DURRËS	44	2,890,000
KRUJË	13	875,000
SHIJAK	18	1,200,000
TIRANË	166	10,820,000
VORË	19	1,265,000
KAVAJË	17	1,135,000
RROGOZHINË	14	940,000
KAMËZ	46	3,020,000
SHKODËR	35	2,305,000
PUKË	15	1,005,000
VAU DEJËS	17	1,135,000
MALËSI E MADHE	20	1,330,000
FUSHË ARRËZ	17	1,135,000
LEZHË	36	2,370,000
MIRDITË	16	1,070,000
KURBIN	17	1,135,000
DIBËR	19	1,265,000
MAT	14	940,000
BULQIZË	12	810,000
KLOS	13	875,000
KUKËS	23	1,525,000
KALIMASH	16	1,070,000
HAS	14	940,000
TROPOJË	16	1,070,000
GJIROKASTËR	25	1,655,000
DROPULL	14	940,000
LIBOHOVË	15	1,005,000
PËRMET	13	875,000
KËLCYRË	14	940,000
MEMALIAJ	10	680,000
BERAT	30	1,980,000
SKRAPAR	15	1,005,000
POLIÇAN	14	940,000
KUÇOVË	14	940,000
DIMAL	17	1,135,000
FIER	29	1,915,000
PATOS	14	940,000
DIVJAKË	13	875,000
ROSKOVEC	13	875,000
MALLAKASTËR	12	810,000
LUSHNJE	14	940,000
VLORË	30	1,980,000
SARANDË	13	875,000
SELENICË	17	1,135,000
KONISPOL	14	940,000
HIMARË	14	940,000
FINIQ	16	1,070,000
DELVINË	14	940,000
TOTALI	1255	83,435,000

**VENDIM****Nr. 836, datë 28.12.2023****PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË
SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË ZNJ.
BRISEIDA JAHOLLARI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 23, datë 18.1.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2023”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të znj. Briseida Jahollari, në masën 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

2. Ky fond përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 837, datë 28.12.2023****PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË
MJEKIMIT TË Z. BUJAR BUKOSHI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 23, datë 18.1.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2023”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Bujar Bukoshi, në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

Faqe | 23796

2. Ky fond përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 838, datë 28.12.2023****PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.
125, DATË 1.3.2023, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E
KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË
DO TË MBËSHTETEN DHE TË MASËS
SË FINANCIMIT NGA FONDI I
PROGRAMIT PËR BUJQËSINË E
ZHVILLIMIT RURAL, PËR VITIN 2023”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 3, e 36, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, të nenit 13, të ligjit nr. 36/2022, “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimi”, dhe të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 7, të vendimit nr. 125, datë 1.3.2023, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

“7/1. Sasia në litra e naftës së përfituar nga subjektet e shpallura fituese për vitin 2023 tërhiqet deri në datën 30.6.2024.”.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 160 lekë